



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



**DREJTORIA E ARSIMIT  
PODUJEVË  
Nr. 05 -264  
16.06.2023**

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 ( Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr.04/L – 032, të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr.05/2021, (MASHI) i datës 18.06.2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit, shpall :

**KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi i lirë/ Zëvendësim	Numri i pozitave
1	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze	Vend i lirë	2
2	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	Vend i lirë	1
3	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe	Zëvendësim	1
4	ShFMU	Mësimdhënës/e për Histori-Edukatë Qytetare	Vend i lirë	2
5	ShFMU	Mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane	Vend i lirë	9
6	ShFMU	Mësimdhënës/e për Matematikë	Vend i lirë	3
7	ShFMU	Mësimdhënës/e për Fizikë	Vend i lirë	2
8	ShFMU	Mësimdhënës/e për Kimi-Biologji	Vend i lirë	2
9	ShFMU	Mësimdhënës/e për TIK	Vend i lirë	3
10	ShFMU	Mësimdhënës/e për Ed.qytetare-gjeografi	Vend i lirë	2

**I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit i plotësuar( merret në komunë - Qendra për shërbime me qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) të noterizuara, certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

## II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021), si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Angleze në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Shqipe në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Histori-Edukatë Qytetare në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Gjuhë Gjermane në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Matematikë në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Fizikë në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Kimi-Biologji në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
  -
  
- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për TIK në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për Edukatë qytetare-Gjeografi në shkollë të mesme të ulët:**
  - Niveli master arsimor Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
  - Sistemi katërvjeçar;
  - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);

**VËREJTJE:** Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 6 paragrafi 18, “Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disipinat nga paragrafi 1-17 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar studimet para hyrjes në fuqi të UA nr.06/2015 të datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim”. neni 11 paragrafi 3, “Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë në nenin 6 të këtij Udhëzimit administrativ”.

- Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t’i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri 50% të vlerësimit përfundimtar.
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitë e lartçekura.
- Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente ( jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi ).
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.
- Për intervistë do të ftohen ata kandidat/e të cilët/at i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartçekura.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

#### **Afati i aplikimit**

**Data e njoftimit** në web-faqen unike të procedurave të konkurimit <https://konkursi.rks-gov.net> është prej datës **16.06.2023** deri më datën **15.07.2023**, ndërsa **koha e aplikimit** është nga data **17.07.2023** deri më datën **31.07.2023**.

Përveç web-faqes unike të procedurave të konkurrimit, konkursi publikohet edhe në web-faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> po ashtu edhe në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës.

## Mënyra e aplikimit

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në portalin për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Podujevës.

***Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.***

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave kandidatët do të informohen përmes njoftimimeve të cilat do të publikohen në web faqen e Komunës së Podujevës dhe në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës, pas mbylljes së konkursit.

## Sqarim:

- Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2023-2024. Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse.

**Drejtoria e Arsimit**

